



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJ & I P-A

Nr. 207 Prot.

Tiranë, më 28.01.2025

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Tiranë

Të nderuar,

Nisur nga detyrimi që rrjedh nga Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nr. 1798 vendimi, datë 22.05.2024, sipas së cilit kërkohet rishpallja e konkursit për 1 (një) vend pune, për pozicionin “**Lektor / As. Lektor, në programin e studimit Pikturë Kavaleti, për lëndët: Nudo, Vizatim dhe Pikturë**”, si dhe

Bazuar në Urdhrin nr. 66, datë 20.11.2017 “Mbi miratimin e Rregullores për procedurat e punësimit të personelit akademik në Universitetin e Arteve”, Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 1 (një) vend pune, sa më poshtë:

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

➤ **NJËSIA BAZË PIKTURË:**

1. Lektor / As. Lektor, në programin e studimit Pikturë Kavaleti, për lëndët: Nudo, Vizatim dhe Pikturë;

1/1. Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo kandidat, për pozicionin e punës: “Lektor” / “As. Lektor” në Programin e studimit Pikturë Kavaleti, në lëndët: Nudo, Vizatim dhe Pikturë.

Kandidati për konkursin duhet të plotësojë këto kritere:

- Kërkesë nga i interesuari ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkuron;



- Diplomë origjinale + fletë notash/fotokopje e noterizuar (shkollë e lartë në profilin përkatës) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MAS;
- Diplomë Doktorature origjinale/fotokopje e noterizuar (në specialitetin për të cilin konkurron) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR, nëse konkurrenti ka kryer studimet e ciklit të tretë;
- Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet, etj);
- Një projekt – program për lëndën për të cilën konkurron;
- Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj/bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë vendit, sipas parashikimeve në legjislacionin shqiptar;
- Të vërtetojë që ka përvojë mësimdhënie në IAL;
- Dy referenca nga profesorë/personalitate të fushës;
- Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
- Fotokopje të letërnjoftimit ose pasaportës;
- Certifikatë familjare;
- Vetëdeklarim që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Dëshmi e gjendjes mjekësore.

Kandidati, në dosjen e tij duhet të ketë:

- Kërkesë nga i interesuari ku të jetë përcaktuar vendi për të cilin ai konkurron;
- Diplomë origjinale + fletë notash (shkollë e lartë në profilin përkatës (mesatare e përgjithshme mbi 8), ose fotokopje e noterizuar, e fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MAS;
- Diplomë për ciklin e tretë të studimeve Doktoraturë, në specialitetin për të cilin konkurron (nëse ka kryer studimet e ciklit të tretë);
- Jetëshkrim (CV), i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- Të ketë përvojë në mësimdhënie IAL (arsimore artistike) jo më pak se 3 (tre) vite brenda/jashtë Shqipërisë;
- Të ketë përvojë pune në realizimin e veprave artistike me specifike të njëjta me lëndën /të ngjashme;
- Të ketë aktivitet të dukshëm artistik, të dëshmuar me katalogë, artikuj, postera, etj.;
- Të ketë njohuri të thella mbi teknikat e pikturës;
- Të jetë pjesëmarrës në takime e konferenca, workshope kombëtare dhe ndërkombëtare me institucione të fushës;
- Të dëshmojë etikë të lartë profesionale dhe morale;



- Të ketë dëshmi/dokumentacion që vërteton angazhimin e tij në tekste mësimore, hartime programesh, artikuj, etj.;
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (në përputhje me Udhëzimin nr. 52/2015 të MAS&R, të ndryshuar);
- Dy referenca nga profesorë me tituj te fushës;
- Dokumente që vërtetojnë përvojën në punë (fotokopje të librezës së punës);
- Fotokopje të letërnjoftimit ose pasaportës;
- Certifikatë familjare;
- Vetëdeklarim që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- Dëshmi e gjendjes mjekësore.

Konkurimi, sipas Urdhrit nr. 66, datë 20.11.2017, do të zhvillohet në dy faza:

		(Vlerësimi maksimal 100 pikë)
Faza e parë	- Shqyrtimi i dosjes së kandidati;	(Vlerësimi gjithsej 50 pikë)
Faza e dytë	- Mësim i hapur/Intervista.	(Vlerësimi gjithsej 50 pikë)

Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e AL në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Procedurave Administrative, në Statutin e Universitetit të Arteve.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Universitetin e Arteve, nga data **03.02.2025**, deri më datë **21.02.2025**, ora 14:00.

Për datën e konkursit, kandidatët do të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ&IP-A, çdo ditë pune, nga ora **08:00** deri në **14:00**.

